



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim nr. 47

Njësia në tender nr. 66

NSH Apiko -Toka në Baballoq

Emri i NSh.-së	NSH Apiko, Deçan ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	12.06.2019 në sallën e konferencave në "Hotel Grand" - Prishtinë
Depozita e Ofertës	Euro 15,000
Vendndodhja e Asetit	Baballoq, Komuna Deçan
<u>Përshkrimi i Asetit</u>	Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe 4ha 85ari 06m² (48506m²) në ZK Baballoq, Komuna Deçan, e cila përfshinë parcelat vijuese: 692/3 me sipërfaqe 6408m², kultura mal kl. 3; 693 me sipërfaqe 5261m², kultura mal kl. 3; 694 me sipërfaqe 660m², kultura kullosë kl. 2; 695 me sipërfaqe 32462m², kultura arë kl. 4; 696 me sipërfaqe 910m², kultura kullosë kl. 2; 697 me sipërfaqe 325m², kultura kullosë kl. 1, dhe; 698 me sipërfaqe 2480m², kultura mal kl. 2. Prona ka qasje në rrugë publike (parcela nr. 822) dhe ndodhet afër magjistrales Pejë- Gjakovë. Shënim: Me datë 20.04.2017 është pranuar një kërkesë pronësore nga Komuna e Deçanit e cila bazohet në vendimin nr. 01.Nr.IV-1 të dt. 11.04.2017 me të cilin Asambleja e Komunës Deçan ka shpallur këtë pronë interes publik për Komunën e Deçanit. Me datë 10 tetor 2018 shkresë i është dërguar Kryetarit të Komunës së Deçanit ku është njoftuar që ky aset është në procedurë të përgatitjes për shitjes dhe nëse Komuna e Deçanit ka vendim për shpronësim të kësaj prone të na përcillet vendimi. Me datë 15.03.2019 është pranuar përgjigje nga Kryetari i Komunës së Deçanit, ku njoftohet se, Komuna është duke bërë përpjekje që të bëjë kërkimin për kthim të pronës në pronësi të Komunës, dhe për këtë arsye kërkon nga AKP që prona të largohet nga privatizimi deri në marrjen e një vendimi nga organet kompetente lidhur me këtë çështje.
Shfrytëzuesit	Nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e asetit në shitje. Nga vizita në teren shihet se toka nuk ishte e punuar, ndërsa ishte e rrethuar nga palë të panjohura dhe pa lejen e AL/AKP.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Foto/ortofoto ose
informata tjera për
asetin në shitje



Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorë
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext.1105, 2055

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Agim Ramadani nr.23 (ish- Ilir Konushevci Nr:8)

10000 Prishtinë/ Pristina, Kosovë

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org